

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"FasadTech Zika" SHPK**

Sot, më datë 04/04/2024, u paraqitën personalisht:

- **Z. Ervis Zika**, i datëlindjes 12/03/1982, shtetas shqiptare, lindur në Tepelenë dhe banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i letërnjoftimit me Nr. Personal I20312220C.
- **Z. Emiliano Zika**, i datëlindjes 27/08/1985, shtetas shqiptare, lindur në Tepelenë dhe banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i letërnjoftimit me Nr. Personal I50827064Q.

e cila përpiloi këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare "**FasadTech Zika**" SH.P.K, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

**Forma Ligjore**

Të themeloj Shoqërinë Tregtare "**FasadTech Zika**" SH.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri "**FasadTech Zika**" SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

**NENI 2**

**Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.**

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme tregtare. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë tërësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

**NENI 3**

**Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit "**FasadTech Zika**" SH.P.K dhe me emrin tregtar **FasadTech Zika**. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 4**

**Objekti i veprimtarisë**

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

- Prodhim, montim dhe konstruksion i materialeve dhe punimeve të plastikës PVC, aluminit, hekurit. Prodhim, montim dhe konstruksion i materialeve të tjera të ndërtimit për fasada, xhama termik, veshje me etalbond, grila me telekomandë, fasada të ventiluara dhe punime të ndryshme ndërtimi.

**NENI 5**

**Selia e Shoqërisë dhe Afati**

Faqe 1 nga 3

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën: **Rr. Artin Basha, Ndërtesa Nr. 501, ZK 3321, Nr. Pas 426/76, Tiranë.**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.

#### **NENI 6**

##### **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar është Lekë 200.000 (dyqind mije leke) dhe zotërohet nga ortakët themelues:

Vlera totale e kapitalit të regjistruar: Lekë 200.000 (dyqind mije leke)

Vlera e paguar: 200.000 leke

Numri total i kuotave: 2.

#### **NENI 7**

Ortakët themelues të Shoqërisë Tregtare "FasadTech Zika" SH.P.K zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

|                          |                                     |
|--------------------------|-------------------------------------|
| Ortaku themelues :       | <b>Ervis Zika</b>                   |
| Numri i kuotave :        | <b>1</b>                            |
| Numri i pjeseve :        | <b>1</b>                            |
| Pjesëmarrja në Shoqëri : | <b>50,00 %</b>                      |
| Lloji i kontributit:     | <b>Ne para</b>                      |
| Vlera e kontributit      | <b>100,000 ( njëqind mije) leke</b> |

|                          |                                     |
|--------------------------|-------------------------------------|
| Ortaku themelues :       | <b>Emiliano Zika</b>                |
| Numri i kuotave :        | <b>1</b>                            |
| Numri i pjeseve :        | <b>1</b>                            |
| Pjesëmarrja në Shoqëri : | <b>50,00 %</b>                      |
| Lloji i kontributit:     | <b>Ne para</b>                      |
| Vlera e kontributit      | <b>100,000 ( njëqind mije) leke</b> |

Duke qenë se Kapitali themeltar do të depozitohet në llogarinë e Shoqërisë e cila do të hapet pas regjistrimit në QKB, atëherë ortakët vendos që kjo shume do të paguhet prej tij jo më vonë 3 muaj nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB, në llogarinë e shoqërisë tregtare.  
Rregullat e pagesës së kësaj shume janë parashikuar në këtë Statut.

#### **NENI 8**

##### **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;



2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

#### **NENI 9**

##### **Administratori/ët**

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit/ëve të cilët zgjidhen për një mandat 5 (pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i shoqërisë do të jete :

- **Z. Ervis Zika**, i datëlindjes 12/03/1982, shtetas shqiptare, lindur në Tepelenë dhe banues ne Tiranë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i leternjoftimit me Nr. Personal I20312220C.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administrator/ët, duke i ushtruar këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### **NENI 10**

Oratku/ Ortakët mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 11**

Ortaku/Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

#### **NENI 12**


Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

#### **NENI 13**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues, u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimit hartohet në gjuhën shqipe, duke qene se ortaku eshte njohes te gjuhes shqipe.


### **ORTAKU THEMELUES**

**Ervis Zika**



Ervis Zika  
24

**Emiliano Zika**



Emiliano Zika

Faqe 3 nga 3

